



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:164241

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05794844

C.nr.625/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. juridike F. Kabashi, në çështjen juridike të paditësit KEDS-Distrikti në P, të cilin e përfaqëson e autorizuar G. H, kundër të paditurit Z. R. B nga fsh. S, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. M. J na S, me padi për kompensimin e dëmit material, në seancën e mbajtur me datë 21.05.2024 në praninë e të autorizuarve të paditësit dhe të paditurit, mori, ndërsa me dt. 07.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit KEDS-Distrikti në P, në të cilën ka kërkuar: “Të aprovohet padija dhe kërkesëpadija e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A, dhe të detyrohet i padituri të paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë 1190.33 €, me kamat ligjore nga dita e ushtrimit të padis deri në pagesën definitive dhe të obligohet me shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësorë në vlerë prej 30 €” .

II. Obligohet paditësi që të paditurit ti kompensoi shpenzimet e procedurës në shumë prej 374,00 €.

A r s y e t i m

Paditësi KEDS-Distrikti në P pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material, ndaj të paditurit Z. B nga fshati S.

E autorizuarja e paditësit në seancë ka deklaruar se edhe me tutje ngelim pranë padisë duke precizuar lartësinë e saj pasi që ka qenë një gabim teknik me rastin e mbledhjes së shumave si në fatura dhe se vlera si në padi prej 1308,35 €, duhet

me qenë 1190,33 €, andaj edhe në këtë drejtim e precizojmë lartësinë e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata ta obligoi paditësin në shumën prej 1190,33 €.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditësit ka theksuar se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar baza dhe lartësia e kërkesëpadisë pasi që provat dhe faktet tregojnë se i padituri Z. B, është përgjegjësi për demin e shkaktuar në emër të rikthimit të humbjeve dhe ai duhet ta kompensoi atë dëme. Njëtori ka qenë i regjistruar në emër të babait të paditurit R. B, ndaj tij është inicuar procedura penale dhe gjykata ka hedhur akuzën për shkak se ka konstatuar se i njëjti është i vdekur. Nga procesverbali me nr. 2274085 i dt. 31.10.2020 është bërë verifikimi i njëtorit elektrik dhe është verifikuar se Z. B, është i biri i R. B. Andaj edhe padia është inicuar ndaj tij, e mbi bazën e faturave të bashkangjitura padisë, nga të cilat edhe ka rezultuar shumën e dëmit të kërkuar. Detyrimi për të paditurin për kompensimin e demit mbështetet në nenin 136 par. 1 të LMD. Ka kërkuar shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore në vlerë prej 30 €.

I autorizuari i të paditurit av. M. J, në përgjigje në padi ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit me pretendimin se demin i shkaktuar nuk është shkaktuar nga ana e paditësit e të gjitha provat tregojnë se procedura penale është zhvilluar ndaj R. B, e jo ndaj të paditurit Z. B. Në seancë gjyqësore ka deklaruar se padia është inicuar për shfrytëzim të pa autorizuar të energjisë elektrike si pasojë e veprës penale dhe sipas Kodit penal kemi të bëjmë me veprë penale e që procedura për vepra penale është inicuar ndaj R. B, pra flasim për fajësinë ndërsa në anën tjetër nuk ka asnjë procedurë penale ndaj të paditurit duke konsideruar se demin lidhet me veprë penale dhe përgjegjësi penale, për qka padia dhe kërkesëpadia e paditësit duhet të hedhet e pa lejuar.

Në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësja me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme bazën ligjore të padisë dhe kërkesëpadisë për demin, është kusht ligjor që për një padi të tillë të ekzistoj faji, kërkesë kjo nga neni 136 par. 1 të LMD. Me asnjë provë nuk është vërtetuar që i padituri të i ketë shkaktuar demin paditëses, i njëjti është i moshës 78 vjeçare dhe nuk ka asnjë mënyrë dhe mundësi që ai të jetë lidhur në rrjetin elektrik siq pretendohet në padi. Në këtë rast nuk ekziston lidhja kauzale për deri sa nuk është vërtetuar fajësia për demin e pretenduar, nuk mund të ekzistoi as demin, qka rezulton se në mungesë të përgjegjësisë për demin të paditurit i mungon edhe legjitimiteti i palës pasive në procedurë. Ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përgjigje në padi shumën 104 €, për dy seanca nga 135 € sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata në kuptim të nenit **7 dhe 8 të LPK-së** bëri administrimin e provave dhe atë: procesverbalim me nr. 2274085 i dt. 31.10.2020, proc. nr. 2272790 i dt. 27.05.2020, kalkulimi i rikthimit të humbjeve i dt. 29.05.2020 me ID e rastit 303369, fatura DPZ HP2015567 e dt. 29.05.2020, procesverbali 2273285 i dt.

25.04.2020, procesverbali 2278377 të dt. 15.02.2020, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 19.02.2020, ID e rastit 202536, fatura DPZHP2015252 e dt. 03.03.2020, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 28.04.2020 me ID 299940, fatura DPZHP2015477 të dt. 28.04.2020, procesverbali nr. 2287698 të dt. 24.08.2019, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 28.08.2019 ID e rastit 263855, fatura DPZHP1914577 të dt. 28.08.2019, procesverbali nr. 2303529 të dt. 13.04.2018, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 14.05.2018 ID e rastit 175447, fatura DPZHP1812971 të dt. 14.05.2018, procesverbali nr. 2432743 të dt. 06.07.2019 kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 15.07.2019 ID e rastit 256506, fatura DPZ19HP14409 të dt. 15.07.2019, procesverbali 0882111 të dt. 27.04.2019, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 07.05.2019 ID e rastit 244548, fatura DPZHP1914199 të dt. 08.05.2019, procesverbali nr. 2302990 të dt. 28.03.2018, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 06.04.2018 ID 172662, fatura DPZHP1812888 të dt. 06.04.2018, procesverbali 0932337 të dt. 10.11.2018, kalkulimi i rikthimit të humbjeve të dt. 14.11.2018 ID. 213228, fatura DPZHP1813653 të dt. 14.11.2018, procesverbalin nr. 0850840 të dt. 16.12.2019, foto dokumentacioni bashkangjitur këtyre procesverbaleve.

Gjykata në shqyrtimin kryesor, pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të autorizuarve të paditësit dhe të paditurit dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga procesverbali me nr. 2273285 i dt. 25.04.2020 provohet se konsumatori me shifrën 62639 për njësinë elektrike 32594168 është R. B, ky fakt provohet edhe me procesverbalet me nr. 2278377 të dt. 15.02.2020, procesverbali 2287698 të dt. 24.08.2019 në të cilin qëndron konstatimi se R. B, refuzon nënshkrimin, procesverbali nr. 2303529 të dt. 13.04.2018, procesverbali me nr. 2432743 të dt. 06.07.2019, në të cilin procesverbal edhe qëndron konstatimi se konsumatori R. B, refuzon të nënshkruaj të njëjtin, procesverbali 0882111 të dt. 27.04.2019 ku qëndron konstatimi se R. B, refuzon nënshkrimin, procesverbali 2302990 të dt. 28.03.2018, ku qëndron konstatimi se konsumatori refuzon të nënshkruaj, procesverbali për ndërrimin e njësitit të konsumatori R. B, 16.12.2019.

Edhe nga faturat e bashkangjitura padisë me nr. DPZHP2015567, DPZHP2015251, DPZHP2015477, DPZHP1914577, DPZHP1812971, DPZ19HP14409, DPZHP1914199, DPZHP 1812888, DPZHP1813653, që të gjitha provojnë faktin se ndaj R. B, në emër të rikthimit të humbjeve është faturuar demigj që ka pësuar paditësi.

Edhe nga kalkulimi i rikthimit të humbjeve për konsumatorin me nr. ID të rastit 263855, 175447, 256506,244548, 172662 dhe 213228 provohet me pa mëdyshje që departamenti për konsumatorin - sektori i rikthimit të humbjeve në vazhdimësi ka bërë raportin e kalkulimit të energjisë së humbur - energjisë së shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar nga konsumatori R. B, dhe në emër të tij ka kalkuluar edhe dëmin i cili ka qenë bazë për faturim të humbjeve . Të vetmin konstatim në provat e prezantuara nga paditësi ku shohim emrin e të paditurit Z. B, është konstatimi në procesverbalin me nr. 2274085 të dt. 31.10.2020, ku konsumatori është R. B, mirëpo në përshkrim thuhet se njëtori është në shfrytëzim të Z. R.B, e që ky konstatim për gjykatën është jo bindës nga se në fund të procesverbalit qëndron konstatimi i bërë nga vete zyrtaret e KEDS-it se konsumatori nuk ka qenë prezent dhe nuk ka nënshkrim të konsumatorit aty , që provon se nuk ka asnjë provë që vërteton faktin se i padituri Z. R. B, e kishte në shfrytëzim këtë njëtori. Për më tepër ky konstatim në këtë procesverbal është në kundërshtim me të gjitha provat e tjera të administruara me lartë në veçanti procesverbalet me nr. 2287698, 0882111 , 2302990, 0932337, ku qëndron konstatimi se R. B, refuzon nënshkrimin.

Gjykata vendosi të refuzoi kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të pa bazuar për faktin se paditësi me provat e prezantuara dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk ka mundur ta bind gjykatën se ka bazë - të drejtë për kompensim të demit material si në faturat e administruara si provë pasi që me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar shkaktari i demit përkatësisht nuk është vërtetuar se paditësi Z. B, ka shkaktuar demin me vepër penale të lidhjes së pa autorizuar në shërbimet e rrjetit elektrik ndërsa kur demi lidhet me veprën penale së pari duhet të vërtetohet përgjegjësia - fajësia e kryerësit me qka do të krijohet baza e përgjegjësisë për demin e më pas të vërtetohet edhe lartësia e demit të pretenduar me çka edhe lind e drejta e paditësit për të kërkuar atë dëme.

Me nenin 136 par. 1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve nr. 04/L-077 është përcaktuar qartë, citoi” *kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoi për veç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, ndërsa me nenin 140 të LMD është përcaktuar “*fajësia ekziston kur dëmtuesi ka shkaktuar demin me dashje ose nga pakujdesia*”. Në këtë çështje kontestimore me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fajësia e të paditurit , gjykata nuk ka mund të vërtetoi bazën e kërkesëpadisë në mungesë të fajit gjykata refuzon edhe lartësinë e kërkuar të kërkesëpadisë duke refuzuar kështu në tersi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të paraqitura nga palët ndërgjyqëse por ka gjetur se nuk kanë asnjë ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori konform nenit 452 par. 1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË
C.nr.625/2020 data 07.06.2024

Gjyqtari
Robert Tunaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.